

Vendim nr. 130, datë 23.04.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Ilir Toska, Anëtar

Genti Ibrahim, Anëtar

në datën 23.04.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (M) 2026 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **MIMOZA NDOKA, BLEDI NDOKAJ**, të përfaqësuar nga avokatët Roven Gashi dhe Dritan Gina, me prokurë të përgjithshme.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 12, datë 03.02.2021 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 23, datë 15.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2025-1657 (262), datë 06.11.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Pezullimi i ekzekutimit të vendimeve objekt kërkesë, për shkak të pasojave të rënda familjare ndaj kërkueses Mimoza Ndoka.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 29, 30, 31, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27 e vijues, 71, 71/a e 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahim, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Bazuar në informacionin e përcjellë nga Komisariati i Policisë Kavajë, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda (*Prokuroria për Krime të Rënda*) ka regjistruar procedimin penal nr. 339 të vitit 2016 (*procedimi penal nr. 339/2016*) për kryerjen nga disa shtetas të veprës penale “Trafikimi i narkotikëve” në bashkëpunim, ndërsa në vijim ka regjistruar në këtë procedim edhe vepra të tjera penale dhe ka vënë në përgjim komunikimet elektronike të shtetasve të dyshuar, nga të cilat kanë rezultuar të dhëna se shtetasi Gj.N. ishte i përfshirë, gjithashtu, në një veprimtari tjetër kriminale, e cila ushtrohej prej tij në bashkëpunim edhe me kërkuesit, respektivisht motra e bashkëshorti i saj. Kjo veprimtari konsistonte në përvetësimin, përmes falsifikimit të dokumenteve, e formularëve e vulave, të pronave shtetërore të ndodhura në zonat bregdetare Ishull Shëngjin, Ishull Lezhë, Mali i Shëngjinit dhe Mali i Rencit.

2. Ky procedim është bashkuar me procedimin penal nr. 250 të regjistruar nga Prokuroria për Krime të Rënda në vitin 2018 për kryerjen e veprave penale “Falsifikimi i dokumenteve”, “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve” në formën e grupit të strukturuar kriminal, “Grupi i strukturuar kriminal”, “Kryerja e veprës penale nga organizata dhe grupi i strukturuar kriminal”, të parashikuara nga nenet 186, 190, 333/a dhe 334 të Kodit Penal (*KP*). Ky i fundit ishte regjistruar prej saj bazuar në aktet e dërguara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë për kryerjen e veprave penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuara nga nenet 186 dhe 248 të KP-së.

3. Në vijim, Prokuroria për Krime të Rënda ka vendosur ndarjen e procedimit penal nr. 339/2016 në nënprocedimin nr. 339/7 të vitit 2016 ndaj disa shtetasve, ndër ta edhe kërkuesit, të cilët i ka akuzuar për kryerjen e veprave penale “Falsifikimi i dokumenteve” në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve” në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, “Shpërdorimi i tokës” në bashkëpunim, “Grupi i strukturuar kriminal”, “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, të parashikuara nga nenet 186,

paragrafi i parë, 190, paragrafi i parë, 28, pika 4, 199, 25, 333/a, paragrafi i dytë dhe 334, pika 1, të KP-së. Krahës këtyre veprave, kërkuesja Mimoza Ndoka është akuzuar edhe për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale”, të parashikuar nga neni 287, shkronja “a”, i KP-së, për shkak se në cilësinë e drejtores së Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (*DAMT*) kishte nënshkruar shkresa për pasuri të regjistruara në mënyrë të kundërligjshme. Ndërsa kërkuesi Bledi Ndokaj është akuzuar edhe për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë e municionit”, të parashikuar nga neni 278, paragrafi i parë, i KP-së, për shkak se në momentin e arrestimit i është gjetur në automjet armë e tipit “pistoletë”, për të cilën nuk ishte pajisur me autorizimin e organeve përkatëse.

4. Në përfundim të hetimeve Prokuroria për Krime të Rënda i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda me kërkesë për dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. 339/7 në ngarkim të kërkuesve dhe disa të bashkëpandehurve të tjerë, kërkesë e cila është miratuar nga gjykata me përjashtim të një të pandehuri, për të cilin ajo ka pushuar akuzën.

5. Në zbatim të vendimeve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor, Prokuroria për Krime të Rënda dhe gjykatat për krime të rënda janë emëruar respektivisht Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), Gjykata e Shkallës së Parë për Korrupsionin e Krimin të Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*) dhe Gjykata e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin të Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*). Në këtë situatë, kërkesa e Prokurorisë për Krime të Rënda për dërgimin në gjyq të çështjes së kërkuesve i ka kaluar për kompetencë GJKKO-së së Shkallës së Parë. Kjo e fundit, në datën 25.09.2020, ka pranuar kërkesën e të pandehurve, përfshirë atë të kërkuesve, për të proceduar me ritin e gjykimit të shkurtuar.

6. Në përfundim të gjykimit përmes këtij riti, me vendimin nr. 12, datë 03.02.2021, GJKKO-ja e Shkallës së Parë e ka deklaruar fajtorë kërkuesen Mimoza Ndoka për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve” në bashkëpunim dhe “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve” në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 186, paragrafi i dytë dhe 190, paragrafi i dytë, të KP-së, ndërsa e ka deklaruar të pafajshme për veprat e tjera penale. Në përfundim, në bashkim të dënimeve dhe në aplikim të nenit 406, pika 1, të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), gjykata e ka dënuar me 1 vit e 4 muaj burgim dhe në zbatim të nenit 59 të KP-së ka pezulluar ekzekutimin e vendimit të dënimit, duke vënë kërkuesen në provë për një afat prej 2 vjetësh e 8 muajsh, me kusht që gjatë kësaj periudhe të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës e të mos

kryejë vepra të tjera penale. Kurse kërkuesin Bledi Ndokaj gjykata e ka deklaruar fajtor vetëm për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë e municionit”, dhe në zbatim të neneve 55 të KP-së e 406, pika 1, të KPP-së, e ka dënuar me 3 vjet e 6 muaj burgim. Gjykata ka vlerësuar se, në kundërshtim nga sa Prokuroria e Posaçme pretendonte, për sa u përket veprave penale të falsifikimit të dokumenteve e falsifikimit të vulave, stampave e formularëve, kërkuesja Mimoza Ndoka kishte bashkëpunuar me të vëllain në formën e bashkëpunimit të thjeshtë dhe jo atë të grupit të strukturuar kriminal, ndërsa nuk provoheshin në nivelin e duhur akuzat për kryerjen e veprave penale të pastrimit të produkteve të veprës penale ose shpërdorimit të tokës. Me të njëjtat argumente, gjykata ka vlerësuar se, me përjashtim të akuzës për mbajtjen pa leje të armës, Prokuroria e Posaçme nuk kishte arritur të provonte akuzat për kryerjen nga kërkuesi Bledi Ndokaj të veprave të tjera penale dhe, për këtë shtetas, rezultatet e përgjimeve telefonike nuk konfirmoheshin nga provat e tjera. Në përfundim, krahas deklarimit fajtorë të kërkuesve dhe të bashkëpandehurve të tjerë, gjykata ka vendosur edhe konfiskimin e kalimin në favor të shtetit të 75 pasurive të paluajtshme rrjedhojë e veprimtarisë kriminale. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim kërkuesit, Prokuroria e Posaçme dhe të bashkëpandehurit e tjerë.

7. Me vendimin nr. 23, datë 15.04.2022, GJKKO-ja e Apelit ka ndryshuar vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë ndaj të dy kërkuesve, duke dënuar kërkuesen Mimoza Ndoka për veprat penale “Grupi i strukturuar kriminal”, “Falsifikimi i dokumenteve”, të kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve”, të kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, “Shpërdorimi i tokës”, të kryer në bashkëpunim dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale”, sipas dispozitave të KP-së të përcaktuara në akuzën e organit të ndjekjes penale. Sipas GJKKO-së së Apelit, në ndryshim nga sa gjykata e shkallës së parë arsyetonte, veprat penale të falsifikimit të dokumenteve dhe falsifikimit të vulave, stampave e formularëve ishin kryer nga kërkuesja Mimoza Ndoka në formën e grupit të strukturuar kriminal, ajo kishte qenë pjesëmarrëse në këtë grup dhe kishte ndërmarrë veprime për pastrimin e produkteve të veprave penale e për ndryshimin e destinacionit të tokës. Po kështu, këto vepra ishin kryer edhe nga Bledi Ndokaj, i cili, krahas dënimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë e municionit”, duhej të dënohej edhe për to. Në zbatim të neneve 55 të KP-së e 406, pika 1, të KPP-së, GJKKO-ja e Apelit e ka dënuar kërkuesen me 5 vjet e 4 muaj burgim, ndërsa kërkuesin Bledi Ndokaj me 6 vjet e 8 muaj burgim. Ndërkohë, kjo gjykatë

e ka vlerësuar si të pabazuar në ligj kërkesën e Prokurorisë së Posaçme për pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim e vënien në provë të kërkuases Mimoza Ndoka, me argumentet se për të nuk ishte marrë asnjë raport i Shërbimit të Provës, sipas neneve 59 e 60 të KP-së e ligjit nr. 78/2020 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës” dhe se dënimi i caktuar ndaj saj ishte mbi 5 vjet, çka përbënte rrethanë penguese, sipas nenit 59 të KP-së. Ndërsa për sa i përket konfiskimit të pasurive, gjykata ka vënë në dukje se kjo pjesë e vendimmarrjes së GJKKO-së së Shkallës së Parë nuk ishte kundërshtuar nga asnjëra prej palëve në proces. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar rekurs kërkuessit dhe të bashkëpandehurit e tjerë.

8. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1657, datë 06.11.2025, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të GJKKO-së së Apelit, me arsyetimin se vendimi i kësaj gjykate mbështetej në analizën e provave materiale, përgjimeve telefonike dhe dokumenteve të sekuestruara, për të cilat kërkuessit kishin pasur mundësinë, hapësirën e kohën e nevojshme për t’i kundërshtuar, në realizim të së drejtës së tyre për mbrojtje efektive, si dhe u kishte dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të tyre, të cilat ishin të pabazuara. Po sipas Gjykatës së Lartë, vendimmarrja e GJKKO-së së Apelit ishte arsyetuar mjaftueshëm edhe në drejtim të masës së dënimit e moszbatimit të nenit 59 të KP-së.

9. Në datën 02.02.2026 kërkuessit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve gjyqësore penale, në pjesën që i kanë deklaruar ata fajtorë dhe dënuar, si dhe pezullimin e zbatimit të tyre.

II

Pretendimet e kërkuessve

10. **Kërkuessit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se u janë cenuar:

10.1. *Parimi i prezumimit të pafajësisë*, i garantuar nga neni 30 i Kushtetutës, pasi prokuroria dhe gjykatat nuk kanë arritur të provojnë akuzat tej çdo dyshimi të arsyeshëm, ndërsa kanë zhvendosur barrën e provës mbi ta. Gjykatat nuk kanë analizuar përmbajtjen e provave, sesi lidheshin ato me njëra-tjetrën dhe nuk arritur të përcaktojnë kontributin e kërkuessve në kryerjen e veprave penale ose elementet e nevojshme për ekzistencën e bashkëpunimit të thjeshtë ose të posaçëm, ndërsa u kanë dhënë përgjimeve vlerë të paracaktuar, ndonëse ato nuk përbëjnë provë, por mjet për kërkimin e provës. Rezultatet e përgjimeve nuk mbështeten në asnjë provë tjetër,

sidomos për kërkuesin Bledi Ndoka, i cili nuk ka pasur funksion shtetëror, nuk ka kryer veprime që lidhen me tjetërsimin e pronave dhe nuk ka ndikuar në asnjë formë në këtë veprimtari. GJKKO-ja e Shkallës së Parë nuk ka administruar asnjë akt ekspertimi që provon falsifikimin, ndërsa GJKKO-ja e Apelit ka listuar në vendim një sërë dokumentesh, pa treguar se cili prej tyre është hartuar, nënshkruar ose lëshuar nga kërkuesja Mimoza Ndoka, ndërsa për 4 dokumentet e nënshkruara prej saj nuk ka përcaktuar ku qëndron falsifikimi në formë, përmbajtje, fshirje, shtim ose pasaktësi të deklaramit. Shkresa së cilës kjo gjykatë i referohet është nxjerrë në ushtrim të funksionit të kërkueses si drejtore e DAMT-së dhe vendosja në të e numrit të protokollit dhe datës nuk ka qenë detyrë e saj, por e zyrës së protokollit. Kërkuesit janë dënuar për veprën penale të falsifikimit të vulave, stampave ose formularëve, ndonëse kërkuesja Mimoza Ndoka nuk ka disponuar ndonjëherë të tilla në ushtrim të funksionit të saj shtetëror, ndërsa kërkuesi Bledi Ndoka nuk ka ushtruar ndonjëherë funksione shtetërore. Po kështu, ata janë dënuar dhe për veprën penale të shpërdorimit të tokës, në bashkëpunim, pa qenë përcaktuar prona private ose shtetërore e shpërdoruar. GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë u kanë atribuar si fakte penale komunikimet që kanë bërë me të pandehurin tjetër, Gj.N., pa marrë parasysh marrëdhënien e posaçme familjare me të. Ato kanë konkluduar për bashkëpunimin në formën e veçantë të organizatës kriminale, që kërkon 3 ose më shumë persona, pa përcaktuar se me cilët persona kanë bashkëpunuar, në mungesë tërësore të provave, në kundërshtim me parashikimet e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, që kërkon formësim të provuar dhe jo të rastësishëm të bashkëpunimit e shtrirje kohore të gjatë dhe të qëndrueshme të aktivitetit kriminal. Kurse akuza për pastrimin e produkteve të veprës penale ka mbetur teorike, për sa kohë që gjykatat nuk e kanë mbështetur atë në asnjë provë. Në disa raste gjykatat e kanë ngatërruar kërkuesin Bledi Ndoka me tjetër shtetas, ish-punonjës hipoteke.

- 10.2. *Parimi ne bis in idem*, si rrjedhojë e zbatimit njëkohësisht të dispozitave materiale penale, konkretisht të nenit 333/a, paragrafi i dytë dhe nenit 334, pika 1, të KP-së, dispozita këto që nuk konkurrojnë, por përthithen nga njëra-tjetra.

10.3. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

- 10.3.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi: i) kërkesa e tyre për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjykues të GJKKO-së së Apelit, si rrjedhojë e vendimmarrjeve të mëparshme të kësaj trupe në procedimin penal nr. 339/2016 në ngarkim të të pandehurit tjetër, Gj.N., nuk është marrë parasysh, ndërsa Gjykata e Lartë nuk e ka marrë në shqyrtim këtë pretendim, ndërsa ka arsyetuar se në lidhje me të nuk evidentohen argumente konkrete; ii) qëndrimi i GJKKO-së së Apelit ka qenë paragjykues, me qëllimin e vetëm për të pranuar çdo akuzë të prokurorisë.
- 10.3.2. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi, duke mos qenë të përfshirë në një organizatë kriminale, shqyrtimi i çështjes nuk ishte në kompetencën e gjykatave të posaçme, por atyre të zakonshme.
- 10.3.3. *Së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u mbrojtur dhe për t'u dëgjuar*, pasi në cenim të nenit 427, pika 4, të KPP-së, gjykata e apelit i ka deklaruar fajtorë pa marrë prova të reja dhe vetëm mbi bazën e vlerësimit ndryshe të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke riçelur hetimin gjyqësor me qëllimin e vetëm dënimin e tyre.
- 10.3.4. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimet gjyqësore janë të paarsyetuara, jologjike dhe me kundërthënie të hapura. GJKKO-ja e Apelit ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë pa arsyetuar për shkaqet mbi të cilat ka rrëzuar gjetjet e asaj gjykate. Në cenim të *nenit 32 të Kushtetutës* ajo ka pranuar se kërkuesi Bledi Ndoka ka bërë deklarime vetinkriminuese, ndaj në lidhje me të nuk nevojiten prova të tjera, ndërsa ka arsyetuar se përgjimet mes tij dhe të pandehurit tjetër, Gj.N., mbështeten edhe në prova të tjera, pa i përmendur ato. Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs, ndër të tjera edhe atyre për zbatimin e nenit 333/a, paragrafi i dytë, të KP-së në raport me nenin 334, pika 1, të këtij kodi, si dhe pretendimeve se pronat e konfiskuara nuk përmbanin vese e se gjykatat më të ulëta duhej të kishin marrë në konsideratë detyrimet civile që lidhen me parashkrimin mirëbesues e pamundësinë e sekuestrimit të sendeve të përdorimit personal.

10.4. *E drejta për jetë familjare në drejtim të proporcionalitetit të ndërhyrjes në lirinë personale dhe parimit të drejtësisë në caktimin e dënimit penal*, pasi GJKKO-ja e Apelit, vendimi i së cilës është lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë, ka dënuar me 5 vjet e 4 muaj burgim kërkuesen Mimoza Ndoka dhe 6 vjet e 8 muaj kërkuesin Bledi Ndokaj, edhe pse prindër të dy fëmijëve të mitur. Duke pasur parasysh rolin dhe marrëdhënien e veçantë të nënës me fëmijët e mitur dhe nevojat e këtyre të fundit, në caktimin e dënimit gjykatat duhet të ishin treguar të kujdesshme t'i jepnin kësaj marrëdhënieje peshën e duhur.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuesve

11. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

12. Kërkuesit, si individë, legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin janë dhënë vendimet e kundërshtuara, për rrjedhojë kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

13. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata ka pohuar se individ mund t'i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke respektuar kërkesat

formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe që të gjitha pretendimet që ngrenë në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë (*shih vendimet nr. 73, datë 19.11.2025; nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 12, datë 09.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në çështjen në shqyrtim Kolegji vëren se kërkuessit kanë pretenduar cenimin e parimit *ne bis in idem*, duke parashtruar si shkak zbatimin njëkohësisht ndaj tyre të neneve 333/a, paragrafi i dytë dhe 334, pika 1, të KP-së. Nga materialet e depozituara së bashku me ankimin kushtetues individual rezulton se një pretendim i tillë është parashtruar në rekurs vetëm nga kërkuessja Mimoza Ndoka, ndaj në lidhje me të Kolegji vlerëson se kërkuessi Bledi Ndokaj nuk ka shteruar mjetet juridike efektive, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.

15. Kërkuessit kanë pretenduar edhe cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspekt të *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, me argumentin se shqyrtimi i çështjes nuk ishte në kompetencën e gjykatave të posaçme. Nga materialet e depozituara së bashku me kërkesën nuk rezulton që ky pretendim të jetë parashtruar prej tyre në ankimin drejtuar GJKKO-së së Apelit, fakt ky i konstatuar edhe nga kjo gjykatë, e cila ka vënë në dukje se një pretendim i tillë ishte parashtruar vetëm nga i bashkëpandehuri tjetër P.S. (*shih vendimin e GJKKO-së së Apelit, faqja 32, pika I*). Në këtë situatë, Kolegji vlerëson se për sa i takon këtij pretendimi kërkuessit nuk kanë shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t'i drejtohen Gjykatës.

16. Po kështu, kërkuessit kanë pretenduar cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*. Nga materialet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të shqyrtimit paraprak dhe ato të depozituara me ankimin kushtetues individual rezulton se këto pretendime janë parashtruar në rekurs vetëm nga kërkuessi Bledi Ndokaj, për rrjedhojë në lidhje me to vlerësohet se kërkuessja Mimoza Ndoka nuk ka shteruar mjetet juridike efektive, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.

17. Kërkuessit kanë pretenduar, gjithashtu, cenimin nga Gjykata e Lartë të *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, me argumentin se kjo gjykatë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tyre se pronat e konfiskuara nuk përmbanin vese dhe se gjykatat më të ulëta duhej të kishin marrë në konsideratë detyrimet civile që lidhen me parashkrimin mirëbesues e pamundësinë e sekuestrimit të sendeve të përdorimit personal. Për sa i takon këtij pretendimi,

Kolegji konstaton se masa e konfiskimit të pasurive, e vendosur nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë, nuk rezulton të jetë ankimuar nga kërkuesit në ankimet e tyre drejtuar GJKKO-së së Apelit, fakt ky i konstatuar edhe nga kjo e fundit (*shih faqen 176, paragrafi i fundit, të vendimit të GJKKO-së së Apelit*). Në këtë situatë, në kushtet kur ky pretendim nuk është parashtruar nga kërkuesit në formë e substancë në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, Kolegji vlerëson se në lidhje me të ata nuk kanë shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.

18. Po kështu, Kolegji vëren se edhe pretendimi për cenimin e *së drejtës për jetë familjare*, si rrjedhojë e dënimit, ndonëse ishin prindër të dy fëmijëve të mitur, nuk është ngritur nga kërkuesit në ankimin drejtuar GJKKO-së së Apelit ose rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë. Në situatën kur në lidhje me të kërkuesit nuk kanë shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara e t’i drejtohen Gjykatës, Kolegji çmon se edhe ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

19. Për sa u përket pretendimeve të tjera, Kolegji evidenton se kërkuesit i kanë parashtruar ato më parë, në formë e substancë, në gjykatat e zakonshme, për rrjedhojë në lidhje me to nuk kanë mjete të tjera juridike në dispozicion përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

20. Kërkuesit legjitimohen edhe *ratione temporis*, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë, që ka përmbyllur procesin gjyqësor të kundërshtuar, mban datën 06.11.2025, ndërsa ankimi kushtetues individual është depozituar në datën 02.02.2026, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

21. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, kërkuesit kanë pretenduar cenimin e parimit të *prezumimit të pafajësisë, parimit në bis in idem* (vetëm kërkuesja Mimoza Ndoka) dhe *së drejtës për proces të rregullt ligjor* (në aspekt të parimit të paanshmërisë së gjykatës, vetëm kërkuesi Bledi Ndokaj), së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t’u mbrojtur e për t’u dëgjuar dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me nenin 32 të Kushtetutës (për kërkuesin Bledi Ndokaj), të garantuara respektivisht nga nenet 30, 34, 42, 17 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës.

22. Kërkuesja Mimoza Ndoka ka pretenduar cenimin e parimit *ne bis in idem*, duke parashtruar si shkak zbatimin njëkohësisht ndaj saj të neneve 333/a, paragrafi i dytë dhe 334, pika 1, të KP-së.

23. Neni 34 i Kushtetutës parashikon se askush nuk mund të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale dhe as të gjykohet sërish, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga një gjykatë më e lartë, sipas mënyrës së parashikuar me ligj. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se *ratio* i kësaj dispozite kushtetuese është sanksionimi i parimit “*të mosgjykimit dhe dënimit dy herë për të njëjtën vepër penale*” (*ne bis in idem*) dhe parimit të “*gjësë së gjykuar*” (*res judicata*), të cilat vijnë si garanci në kuadër të mbrojtjes të të drejtave të individit në fushën penale (*shih vendimet nr. 11, datë 13.03.2025; nr. 47, datë 05.10.2023; nr. 33, datë 22.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Po kështu, Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës ka mbajtur qëndrimin se kur i pandehuri kryen vepër penale në rrethanën cilësuese të bashkëpunimit në formën e krimit të organizuar, zbatimi i nenit 334 të KP-së nuk cenon parimin *ne bis in idem*. Në këto raste, zbatimi i nenit 334 të KP-së shton masën e dënimit të parashikuar nga ligji për veprën penale të kryer për shkak të rrethanës cilësuese të pjesëmarrjes në krim të organizuar. Në këtë kuptim, neni 334 i KP-së nuk zbatohet veçmas dhe nuk është autonom, por ai shoqëron dispozitën penale të veprës konkrete të kryer dhe e cilëson atë si të kryer nga organizata kriminale ose grupi i strukturuar kriminal (*shih vendimin nr. 42, datë 05.04.2022 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Edhe sipas jurisprudencës njësuere të Gjykatës së Lartë, nenet 28, 333, 333/a dhe 334 të KP-së plotësojnë njëri-tjetrin në penalizimin e bashkëpunimit të veçantë kriminal. Dispozita e përgjithshme, neni 28 i KP-së, parashikon të gjitha format e bashkëpunimit të veçantë, të tilla si: organizata kriminale, organizata terroriste, banda e armatosur dhe grupi i strukturuar kriminal, ndërsa dispozitat e posaçme, nenet 333, 333/a të KP-së, parashikojnë si vepra penale krijimin, organizimin ose drejtimin apo pjesëmarrjen në organizatën kriminale ose në grupin e strukturuar kriminal. Nga ana tjetër, ndonëse neni 334 i KP-së është dispozitë materiale dhe në pjesën e posaçme të KP-së, në raport me paragrafët 5 e 6 të nenit 28 të këtij kodi, nuk parashikon një vepër penale më vete, por një dënim që i shtohet dënimit të caktuar nga gjykata për veprën penale konkrete të kryer nga organizatori ose pjesëmarrësi në një organizatë kriminale apo në një grup të strukturuar kriminal dhe ka si qëllim pikërisht mënyrën e caktimit të dënimit për veprat penale të kryera në formën e grupit të strukturuar kriminal e të organizatës kriminale. Zbatimi i nenit 334, në raport me nenet 333 dhe 333/a të KP-së, nuk cenon parimin *ne bis in idem*, të parashikuar nga neni 7 i KPP-së, por përbën një dënim të shtuar vetëm kur pjesëtarët e organizatës kriminale

ose grupit të strukturuar kriminal kryejnë një vepër penale konkrete (*shih vendimin njësues nr. 00-2024-2155 (107), datë 24.04.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

26. Në këndvështrim të jurisprudencës së mësipërme në rastin konkret Kolegji vëren se GJKKO-ja e Apelit nuk ka deklaruar fajtores kërkuesen për veprën penale të parashikuar nga neni 334 i KP-së, por në zbatim të tij u ka shtuar dënimeve të caktuara ndaj saj për veprat penale të parashikuara nga nenet 186, paragraf i parë, 190, paragrafi i parë dhe 28, pika 4, të KP-së edhe dënimin për rrethanën e kryerjes së tyre në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, sipas nenit 334, pika 1, të KP-së. Pretendimet e kërkueses në këtë drejtim janë vlerësuar në vijim nga Gjykata e Lartë, e cila, referuar vendimit të saj njësues të sipërcituar, duke vënë në dukje edhe se neni 333/a i KP-së nuk konkurron me veprat e tjera të kryera nga grupi i strukturuar kriminal, i ka gjetur ato të pabazuara. Nga ana tjetër, Kolegji thekson se vetë pjesëmarrja në grup të strukturuar kriminal përbën vepër penale sipas nenit 333/a të KP-së edhe atëherë kur grupi nuk ka kryer një vepër penale të caktuar, sikurse gjykatat kanë pranuar edhe në rastin e kërkueses, duke e deklaruar fajtores e dënuar për këtë vepër penale. Nën këtë optikë, në kushtet kur neni 334, pika 1, i KP-së është zbatuar nga gjykata vetëm për qëllime të masës së dënimin për shkak të formës së posaçme të bashkëpunimit, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkueses Mimoza Ndoka për cenimin e parimit *ne bis in idem*, për shkak të zbatimit njëkohësisht ndaj saj të kësaj dispozite dhe të nenit 333/a, paragrafi i dytë, të KP-së, është haptazi i pabazuar.

27. Në ankimin kushtetues individual kërkuesi Bledi Ndoka ka pretenduar cenimin e parimit të paanshmërisë së gjykatës, duke parashtruar si shkaqe: i) mospranimin nga GJKKO-ja e Apelit të kërkesës së tij për përjashtimin e trupit gjykues e mosdhënien përgjigje nga Gjykata e Lartë për këtë pretendim; ii) paragjykimin e çështjes nga GJKKO-ja e Apelit.

28. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet subjektiv, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin objektiv, me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimin prej saj të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Gjykatat e zakonshme duhet të marrin parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanojnë nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv. Paragjykimi i mundshëm për paanshësinë e gjyqtarit mund të ngrihet edhe në hipotezën kur gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbytjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin

subjekt (*shih vendimet nr. 4, datë 25.02.2009; nr. 12, datë 13.04.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Po sipas Gjykatës, pjesëmarrja e të njëjtëve gjyqtarë në gjykime të tjera që lidhen me të njëjtën organizatë kriminale, por mbi çështje, fakte dhe vlerësime të ndryshme nga ato që i përkasin gjykimit penal ndaj kërkuesit, nuk përbën shkak objektiv që të ngrejë dyshime të justifikuara mbi anësinë e tyre (*shih vendimin nr. 33, datë 22.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, për sa i takon shkakut të parë, mospranimin nga GJKKO-ja e Apelit të kërkesës së kërkuesit Bledi Ndokaj për përjashtimin e gjyqtarëve të saj e mosdhënien përgjigje për këtë pretendim nga Gjykata e Lartë, nga materialet e dosjes gjyqësore, të administruar për qëllime të shqyrtimit paraprak, rezulton se gjatë gjykimit të çështjes në atë gjykatë ky kërkues ka kërkuar përjashtimin e trupit gjykues, duke parashtruar si shkak se gjyqtaret në përbërje të tij kanë gjykuar në shkallë të parë dhe në apel çështjen penale në ngarkim të të pandehurit tjetër, Gj.N., dhe të pandehurve të tjerë, të akuzuar për kryerjen e veprave penale “Trafikimi i lëndëve narkotike” në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal etj. (*shih procesverbalin e seancës së GJKKO-së Apelit të datës 13.12.2021, faqja 3*). Pas marrjes së mendimeve të gjyqtareve, të cilat kanë kërkuar mospranimin e kërkesës, me argumentin se çështjet ishin të ndryshme dhe shkaqet e parashtruara për paanshmëri nuk ishin nga ato të parashikuara nga KPP-ja, gjyqtarja e vetme e GJKKO-së së Apelit ka rrëzuar kërkesën, me arsyetimin se, në kuadër të dy çështjeve penale të krijuara si pasojë e ndarjes të të njëjtit procedim penal, faktet penale atribuar të pandehurit tjetër Gj.N. ishin tërësisht të ndryshme dhe gjyqtaret nuk ndodheshin në asnjë prej kushteve të papajtueshmërisë, në kuptim të neneve 15, 16, 17 dhe 18 të KPP-së (*shih vendimin nr. 40, datë 15.12.2021 të gjyqtareve të vetme të GJKKO-së së Apelit*). Ky qëndrim i gjyqtareve është vlerësuar i drejtë edhe nga Gjykata e Lartë, sipas së cilës pretendimet në fjalë nuk cenonin vendimmarrjen objekt rekursi, pasi nuk evidentoheshin argumente konkrete të paanshmërisë së gjyqtareve (*shih faqet 85-86, paragrafi 62, të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

30. Në analizë të këtyre vendimmarrjeve, Kolegji vëren se pretendimi i kërkuesit për paanshmërinë e gjyqtareve të GJKKO-së së Apelit nuk është ngritur në kuadër të një procedimi penal që lidhet me të njëjtat fakte dhe me të njëjtin subjekt, por në raport me një çështje tjetër, që i referohet rrethanave faktike dhe subjekti të ndryshëm. Në këto kushte, Kolegji çmon se vetëm fakti i pjesëmarrjes së të njëjtave gjyqtare në shqyrtimin e një tjetër procedimi, në vetvete, nuk është i mjaftueshëm për të mbështetur dyshimet për paanshmërinë e tyre në gjykimin e çështjes së kërkuesit. Ndaj, në këtë kuptim, qëndrimi i gjykatave të zakonshme nuk rezulton arbitrar në

këndvështrimin kushtetues, në kuptimin që të vijë në kundërshtim me konceptin e gjykimit të drejtë, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës. Po kështu, në kundërshtim nga sa kërkuesi pretendon, Gjykata e Lartë ka marrë në shqyrtim në shqyrtim pretendimin për cenimin e parimit të paanshmërisë së gjykatës, duke arsyetuar qëndrimin e saj në lidhje me të. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, është haptazi i pabazuar.

31. Për sa i takon shkakut të dytë, qëndrimin paragjykses të GJKKO-së së Apelit, duke mbajtur në konsideratë testin objektiv dhe subjektiv të parimit të paanshmërisë së gjykatës të përcaktuar nga jurisprudenca kushtetuese, të cilët kërkojnë mungesën e paragjyksimeve nga gjyqtarët në lidhje me çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njërës prej palëve, si dhe ofrimin nga gjyqtari të garancive procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë (*shih vendimet nr. 17, datë 10.04.2025; nr. 23, datë 04.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese*), Kolegji vlerëson se ky kërkues nuk ka arritur të argumentojë nga pikëpamja kushtetuese cenimin e këtij parimi, pasi, në kushtet kur prokurori kishte paraqitur apel, fakti se GJKKO-ja e Apelit ka ndryshuar qëndrimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë në përkeqësim të pozitës së tij juridike, nuk përbën shkak kushtetues për vënien në dyshim të paanshmërisë së asaj gjykate. Për rrjedhojë, edhe ky pretendim i kërkuesit Bledi Ndokaj është haptazi i pabazuar.

32. Kërkuesit kanë pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u mbrojtur dhe për t'u dëgjuar, duke parashtruar si shkak se GJKKO-ja e Apelit i ka deklaruar fajtorë pa marrë prova të reja dhe vetëm mbi bazën e vlerësimit të ndryshëm të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, në cenim të nenit 427, pika 4, të KPP-së.

33. Neni 427, pika 4, i KPP-së, sipas përmbajtjes së kohës, ka parashikuar se kur i pandehuri është deklaruar i pafajshëm, gjykata e apelit nuk mund ta deklarojë atë fajtor vetëm mbi bazën e vlerësimit të ndryshëm të provave të marra në gjykimin në shkallë të parë. Në këtë rast gjykata e apelit përsërit shqyrtimin gjyqësor.

34. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se është në diskrecion të gjykatës së apelit të vendosë, rast pas rasti, përsëritjen ose jo të shqyrtimit gjyqësor, sipas nenit 427, pika 4, të KPP-së (*shih vendimin nr. 55, datë 10.10.2025 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, sipas jurisprudencës njësuere të Gjykatës së Lartë, neni 427, pika 4, i KPP-së nuk pengon gjykatën të përsërisë shqyrtimin gjyqësor e të marrë prova të reja edhe në rastet kur gjykimi në shkallë të parë

është zhvilluar përmes procedurës së gjyimit të shkurtuar. Kur gjykata e apelit vendos përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor e vlerëson këtë disponim në raport me nevojën e verifikimit të fakteve ose provave të çështjes në gjykim, nëse në apel janë ngritur çështje të vlerësimit të gabuar të provave nga gjykata e shkallës së parë. Detyrimi i gjyqtarit të apelit për të proceduar, qoftë edhe kryesisht, me rimarrjen e provave bëhet kur është i nevojshëm një vlerësim i ndryshëm i besueshmërisë së një prove që konsiderohet e rëndësishme dhe përcaktuese për qëllimin e vendimit të ndryshëm nga ai i pafajësisë. Fizionomia e provës vendimtare i referohet idesë se vendimi i gjyqtarit të apelit bazohet në një vlerësim të ndryshëm të provës që ka nevojë të dëgjohet, në mënyrë verbale e të drejtpërdrejtë në gjykim, merret drejtpërdrejt, të diskutohet, të kundërshtohet, kjo edhe në mundësinë që kjo provë e marrë në këtë mënyrë të konfirmojë edhe pafajësinë (*shih vendimin njëses nr. 00-2024-2162 (275), datë 06.11.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

35. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në rastin konkret, Kolegji evidenton se GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka deklaruar fajtores kërkuar Mimoza Ndoka vetëm për veprat penale të falsifikimit të dokumenteve dhe falsifikimit të vulave, stampave ose formularëve, të kryera në bashkëpunim, ndërsa e ka deklaruar atë të pafajshme për veprat e tjera penale. Po kështu, kërkuar Bledi Ndokaj është deklaruar fajtor nga kjo gjykatë vetëm për veprën penale të mbajtjes pa leje e prodhimit të armëve, armëve shpërthyes e municionit. Në kushtet e deklarimit të pafajshëm të kërkuarve për disa prej akuzave të prokurorisë, në zbatim të detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 427, pika 4, të KPP-së, GJKKO-ja e Apelit ka përsëritur shqyrtimin gjyqësor, duke marrë të njëjtat prova si GJKKO-ja e Shkallës së Parë dhe ka konkluduar në përfundim të gjyimit se kjo e fundit kishte bërë vlerësim të gabuar të tyre, ndaj kërkuarit duheshin dënuar edhe për veprat e tjera për të cilat ishin akuzuar. Gjykata e Lartë ka vlerësuar të drejtë këtë veprim procedural të gjykatës së apelit, me argumentin se ripërsëritja e shqyrtimit gjyqësor duke marrë të njëjtat prova nuk përbënte shkelje të ligjit procedural me pasojë cenimin e vendimit, aq më tepër kur fajësia e kërkuarës nuk ishte mbështetur në prova deklarative, por në prova dokumentare (*shih faqen 84, paragrafi 59, të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

36. Në vlerësim të qëndrimeve të gjykatave të zakonshme, duke mbajtur në konsideratë se provat mbi të cilat është gjykuar çështja kanë qenë ato të mbledhura gjatë hetimit paraprak dhe kërkuarit kanë përfituar nga garancitë që ofron gjykimi i shkurtuar, si dhe se gjykimi i çështjes është bërë nga GJKKO-ja e Apelit në seancë publike, ku kërkuarit janë përfaqësuar me mbrojtës të zgjedhur, të cilëve u është dhënë mundësia të shprehen për faktet dhe provat e ligjshmërinë e

vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë, në garantim të së drejtës së tyre të aksesit, për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, Kolegji çmon se pretendimet e kërkuësve për cenimin e këtyre të drejtave, si rrjedhojë e deklaramit të tyre fajtorë nga GJKKO-ja e Apelit pa marrë prova të reja, janë haptazi të pabazuara.

37. Në ankimin kushtetues individual kërkuësit kanë pretenduar gjithashtu cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, si dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Duke pasur parasysh argumentet në themel të tyre, Kolegji çmon t'i analizojë ato në drejtim të parimit të prezumimit të pafajësisë, duke iu referuar për këtë qëllim arsyetimit të gjykatave të zakonshme.

B. Për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë

38. Kërkuësit kanë pretenduar se gjykatat nuk kanë arritur të provojnë akuzat tej çdo dyshimi të arsyeshëm, ndërsa u kanë kaluar atyre barrën e provës. Sipas tyre, gjykatat nuk kanë kryer një analizë të plotë dhe të ndërlidhur të provave, nuk kanë përcaktuar kontributin konkret të secilit kërkuës në kryerjen e veprave penale dhe të elementet e bashkëpunimit, ndërkohë që u kanë dhënë përgjimeve vlerë të paracaktuar, pa u mbështetur në prova të tjera, veçanërisht për kërkuësin Bledi Ndoka, i cili nuk ka pasur funksion shtetëror, dhe pa marrë parasysh marrëdhënien e posaçme familjare me të pandehurin familjar të tyre. Ata janë dënuar për veprat penale të falsifikimit të vulave e formularëve dhe për shpërdorimin e tokës, në bashkëpunim, pa u përcaktuar objekti konkret i veprës. Gjykatat nuk kanë përcaktuar rolin e kërkuëses Mimoza Ndoka e mënyrën e falsifikimit në dokumentet e nënshkruara prej saj dhe nuk kanë administruar ndonjë akt ekspertimi që provonte falsifikimin. Ato kanë konkluduar për kryerjen e veprave penale në format e veçanta të bashkëpunimit, pa identifikuar personat me të cilët kanë bashkëpunuar. Akuza për pastrimin e produkteve të veprës penale nuk është mbështetur në prova dhe në disa raste gjykatat kanë identifikuar në mënyrë të gabuar kërkuësin Bledi Ndoka, ndërkohë që bëhej fjalë për tjetër shtetas. GJKKO-ja e Apelit ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë pa arsyetuar për shkaqet mbi të cilat ka rrëzuar gjetjet e asaj gjykate, ndërsa ka pranuar se Bledi Ndoka ka bërë deklarime vetinkriminuese, në cenim të nenit 32 të Kushtetutës. Kurse Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs.

39. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se, në rastin e gjykimit penal, parimi i prezumimit të pafajësisë është një nga elementet përbërëse të

procesit të rregullt ligjor. Ai kërkon që deklarimi i fajësisë të të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes. Asnjë masë që barazohet me dënimin nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 27, datë 29.04.2025; nr. 20, datë 03.04.2024; nr. 4, datë 21.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet. Barra e provës i takon palës akuzuese dhe çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit. Gjykatat duhet ta mbështesin vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza. Ato janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime ose dyshime (*shih vendimet nr. 26, datë 29.04.2025; nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 12, datë 24.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, Kolegji do të verifikojë në vijim nëse në gjykimin e çështjes gjykatat e zakonshme kanë respektuar garancitë kushtetuese të lidhura me parimin e prezumimit të pafajësisë. Konkretisht, Kolegji do të analizojë nëse gjykatat u kanë kaluar kërkuesve barrën e provës, nëse kanë provuar fajësinë e tyre përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, nëse kanë bërë gabime të dukshme në drejtim të përcaktimit të fakteve në raport me veprat penale për të cilat kërkuesit janë dënuar, si dhe nëse vendimmarrjet e tyre janë arsyetuar në drejtim të shkaqeve mbi të cilat janë bazuar në përfundimet respektive.

41. Në rastin konkret, Kolegji vëren se Prokuroria e Posaçme ka dërguar në gjyq çështjen penale në ngarkim të kërkuesve, të akuzuar për kryerjen e veprave penale të falsifikimit të dokumenteve, në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal; falsifikimit të vulave, stampave ose formularëve, në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal; shpërdorimit të tokës, në bashkëpunim; grupit të strukturuar kriminal; kryerjes së veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal, si dhe kryerjes nga kërkuesja Mimoza Ndoka edhe të veprës penale pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale, ndërsa nga kërkuesi Bledi Ndokaj të veprës mbajtja pa leje e prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë e municionit.

42. Gjatë gjyimit përmes ritit të gjyimit të shkurtuar, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka marrë në shqyrtim provat e mbledhura gjatë hetimit paraprak, të tilla si: deklaratimet e personave që kishin dijeni për veprat penale, deklaratimet e të pandehurve, transkriptimet e përgjimeve të realizuara gjatë hetimit të procedimit në fjalë, aktet e këqyrjeve e sekuestrimeve, provat dokument

dhe aktet e ekspertimit grafik të kryera ndaj dokumenteve “Akt i marrjes së tokës në pronësi” (ATMP). Në analizë të tyre, si dhe në interpretim të llojeve të falsifikimit (material e intelektual), gjykata ka vlerësuar se dokumentet e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Lezhë, si dhe përgjimet telefonike dokumentonin veprimet e kundërligjshme të kryera nga kërkuesja Mimoza Ndoka, e cila së bashku me vëllain e saj, Gj.V., e familjarë të tjerë kishte vepruar në ndryshimin e destinacionit të pasurive shtetërore dhe në përvetësimin pa të drejtë të tyre. Në cilësinë e drejtores së DAMT-së, Lezhë, ajo nuk kishte konfirmuar llojin e pasurisë në përgjigje të kërkesës së ZVRPP-së, Lezhë, ndërsa i kishte bashkëlidhur një fletë fotokopje të regjistrit të ngastrave, e cila nuk rezultonte e nënshkruar nga personi përgjegjës, për të vërtetuar nëse ishte autentike. Të dhënat në këtë fletë binin ndesh me origjinën fillestare të pasurisë, të cilat sipas ligjit për tokën nuk mund të tjetërsohen. Po kështu, në të tjera raste, ajo nuk kishte konfirmuar zërin kadastral të pasurisë me dokumentet e arkivës së institucionit ku drejtonte. Problematikat në numra, data, referenca e pasaktësitë e dokumentacionit për regjistrimin e pasurive me burime pronësie ATMP fiktive konfirmonin veprimet e kundërligjshme të saj për përvetësimin e pasurive shtetërore përmes përdorimit të dokumenteve të falsifikuara. Kurse përgjimet informonin për dijeninë e saj për veprimet e kundërligjshme të vëllezërve, dijeni që vinte si rrjedhojë e lidhjes së gjakut mes tyre, ndërsa nuk provonin pjesëmarrjen e saj në grupimin kriminal ose kontributin në këtë organizim. Po sipas gjykatës, përfshirja e kësaj kërkueseje në kryerjen e veprave penale ishte bërë në formën e bashkëpunimit të thjeshtë dhe jo atij të posaçëm, ndërsa nuk provoheshin në nivelin e duhur kryerja prej saj e veprës pastrimi i produkteve të veprës penale, pasi nuk rezultonte të kishte kryer tjetërsim të pasurive me qëllim pastrimin e origjinës së tyre ose e veprës penale të shpërdorimit të tokës. Në përfundim, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se për veprat penale të kryera kjo kërkuese duhej dënuar përfundimisht me 1 vit e 4 muaj burgim, ndërsa në zbatim të nenit 59 të KP-së e ka vënë atë në provë për një afat prej 2 vjetësh e 8 muajsh.

43. Kurse për sa i përket kërkuesit Bledi Ndokaj, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka çmuar se nga provat nuk provohej tej çdo dyshimi të arsyeshëm që ai të kishte falsifikuar ose përdorur dokumente ose akte të falsifikuara, të kishte kryer veprime konkrete në ofrimin e kontributit të tij në organizimin kriminal në funksion të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurive shtetërore përmes falsifikimit ose përdorimit të dokumenteve të falsifikuara apo falsifikimit ose përdorimit të vulave të tyre. Provat mbi të cilat mbështetej organi i akuzës për marrjen në përgjegjësi penale

të këtij shtetasi ishin komunikimet telefonike me të pandehurin tjetër, Gj.N., të cilat nuk konfirmoheshin nga provat e tjera dhe nuk ngrinin dyshime të arsyeshme për fajësinë e tij. Ndërsa, në kushtet kur në gjykim ishte provuar mbajtja pa autorizim të organeve kompetente të armës së gjetur në posedim të këtij kërkuesi, duke qenë ky në kushtet e veprimit të kundërligjshëm të parashikuar nga neni 278, paragrafi i parë, i KP-së, e ka dënuar atë përfundimisht me 3 vjet e 6 muaj burgim.

44. Në ndryshim nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se provat e paraqitura nga akuza provonin përtej çdo dyshimi të arsyeshëm kryerjen nga kërkuesit të veprave penale të falsifikimit të dokumenteve dhe falsifikimit të vulave, stampave ose formularëve në marrëveshje paraprake dhe të programuar, në formën e grupit të strukturuar kriminal, siç parashikohej nga neni 333/a, paragrafi i dytë, i KP-së. Sipas këtyre provave, rezultonte se kërkuesit ishin anëtarësuar në grupin e strukturuar kriminal të krijuar nga Gj.N. për qëllime të kryerjes së veprave penale të falsifikimit të dokumenteve dhe të falsifikimit të vulave, formularëve ose stampave, me synimin e përfitimit material, përvetësimit të qindra hektarëve sipërfaqe toke pasuri shtetërore në emër të tyre e familjarëve të tyre ose ndarjes e tjetërsimit të pasurive të përfituara në mashtrim të ligjit. Kërkuesit kishin pasur dijeni për kryerjen e këtyre veprave nga Gj.N. dhe të pandehurit e të tjerë, anëtarë të së njëjtës familje, topografë, regjistruar, juristë e noter, secili prej tyre me detyra të mirëpërcaktuara, dhe me vullnet kishin marrë pjesë në këto veprimtari për përmbushjen e qëllimeve të grupit kriminal. Rezultatet e përgjimeve telefonike, të kryera në një hark të gjatë kohor, kishin fuqi të plotë provuese, pasi transmetonin qartë e me siguri njoftime/dije për fakte të pjesëmarrjes të të pandehurve në krime të cilat lidheshin me veprime të tyre konkrete. Bashkëbiseduesit, anëtarë të të njëjtit grup kriminal, drejtpërdrejt, me gjuhë të kuptueshme dhe lehtësisht të deshifrueshme, njoftonin faktet penalisht të rëndësishme të përvetësimit në bashkëpunim të pasurive, përfshirë pasurisë nr. 1018/1 të regjistruar në emër të tyre. Pasi e shtinin në dorë pasurinë e përvetësuar, ata silleshin si pronarë të ligjshëm të saj, duke i lejuar vetes edhe faljen e saj të tjerëve. Po kështu, kërkuesit kishin kryer edhe veprën penale të shpërdorimit të tokës, pasi në bashkëpunim kishin ndryshuar regjimin juridik të saj nga “tokë e zënë me pyll” ose “tokë jobujqësore” në “tokë bujqësore”, duke vepruar në kundërshtim me destinacionin e saj e ligjet përkatëse që parashikojnë rregullat themelore në mbrojtjen nga shpërdorimi të tokave të zëna me pyje dhe tokave vijë bregdetare.

45. Po sipas GJKKO-së së Apelit, në kundërshtim nga sa kërkuesja Mimoza Ndoka pretendonte, dokumentet e sekuestruara provonin kontributin e saj në përpilimin e akteve me përmbajtje të rreme, me qëllim regjistrimin e titujve të falsifikuar të pronësisë për t'i kaluar për llogari të grupit të strukturuar kriminal, nga i cili kishte nxjerrë përfitime të mëdha pasurore, përfshirë edhe pasuri të paluajtshme. Në cilësinë e drejtores së DAMT-së ajo kishte dhënë njoftime të falsifikuara mbi gjendjen e origjinës së tokave, duke i paraqitur ato sipas akteve të marrjes në pronësi e jo sipas përmbajtjes së dokumentacionit për origjinën e vërtetë të tyre, si dhe kishte falsifikuar në përmbajtje shkresat drejtuar ZVRPP-së, Lezhë lidhur me regjimin juridik të tokës për pasuritë në ngarkim të Z.N. dhe Gj.S.Ç. (*shih faqet 45-46, 54-58 të vendimit të GJKKO-së së Apelit*). Edhe pse ishte në dijeni të faktit se regjimet pasqyroheshin ndryshe nga sa rezultonin në dokumentacionin origjinal, ajo kishte lejuar regjistrimin si tituj pronësie të dokumenteve të falsifikuara, duke plotësuar praktikën e regjistrimit të ATMP-së me dokumente që përmbanin të dhëna në kundërshtim me faktin e treguar në regjistrat kadastralë, për t'i bërë ato të vlefshme. Duke transferuar pasurinë tek personat e tjerë, me qëllim mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, si dhe duke futur në qarkullimin civil, nëpërmjet transferimit dhe regjistrimit në ZVRPP-në, Lezhë, token e përvetësuar mbi dokumente të falsifikuara, Mimoza Ndoka kishte kryer edhe veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale.

46. Lidhur me kërkuesin Bledi Ndokaj, sipas GJKKO-së së Apelit, duke vlerësuar se ai ishte i pafajshëm për disa nga veprat penale, me argumentin se përgjimet telefonike nuk konfirmoheshin nga provat e tjera, GJKKO-ja e Shkallës së Parë kishte zbatuar në mënyrë të gabuar rregullin e nenit 152, pika 3, të KPP-së, pasi në provueshmërinë e fajësisë të bazuar në bashkëbisedimet e përgjuara ndërmjet personave që u atribuoheshin krimet nuk aplikoheshin rregulli i çmuarjes së provave sipas kësaj dispozite, sepse ato nuk ishin të ngjashme me deklaratimet që i bashkëpandehuri në të njëjtin krim ose i të pandehurit në një procedim të lidhur bënin gjatë marrjes në pyetje përpara autoriteteve gjyqësore. Për to vlente rregulli i përgjithshëm i çmuarjes së kujdesshme të provave nga gjykata, sipas pikës së parë të kësaj dispozite. GJKKO-ja e Shkallës së Parë i kishte vlerësuar si të veçuara bisedat e bëra ndërmjet këtij kërkuesi e të pandehurit Gj.N., duke u dhënë atyre vlerën e indicieve, edhe pse shprehnin aleancën e marrëveshjen e bashkëpunimit të veçantë me njëri-tjetrin. Në kundërshtim nga sa ajo gjykatë kishte konkluduar, përgjimet provonin faktin se Bledi Ndokaj merrte urdhra nga i pandehuri Gj.N., drejtuesi i grupit kriminal, të cilat pranonte t'i zbatonte, çka vërtetonte rolin e tij si pjesëmarrës brenda grupit të

strukturuar kriminal. Rezultatet e përgjimeve telefonike, nga të cilat rezultonte se i pandehuri Bledi Ndokaj kishte qenë aktor kryesor si një nga bashkëbiseduesit, përputheshin plotësisht me provat e tjera, të cilat i konfirmonin ato. Komunikimet e tij me të pandehurin Gj.N. përmbanin pohime vetakuzuese, duke përbërë provë të drejtpërdrejtë të fajësisë së tij, e cila konfirmohej edhe nga provat “dokument” e aktet e ekspertimit grafik. Përgjimet tregonin se ai kishte qenë në dijeni të faktit se kalimi, përmes dokumenteve të falsifikuara, i pronësisë për pasurinë nr. 1018/1, “ranishte” do të pasohej nga veprimi tjetër kriminal i kalimit të saj nga Z.N. te Gj.N., Mimoza Ndoka e familjarët e tjerë, çka përputhej edhe me praktikën dokumentare të regjistrimit të kësaj pasurie. Po kështu, ai kishte qenë në dijeni edhe të veprimeve të tjera kriminale të grupit të strukturuar kriminal për falsifikimin e dokumenteve dhe vulave, me qëllim përfitimin e pasurisë shtetërore, ndërsa rezultonte se kishte kryer edhe veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve.

47. Në përfundim, në zbatim të nenit 406, pika 1, të KPP-së, GJKKO-ja e Apelit ka vendosur dënimin e kërkueses Mimoza Ndoka me 5 vjet e 4 muaj burgim dhe, duke e gjetur të drejtë arsyetimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë vetëm lidhur me dënimin e kërkuesit Bledi Ndokaj për veprën penale të mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyes e municionit, ka vlerësuar se, në zbatim të nenit 406, pika 1, të KPP-së, ai duhej dënuar përfundimisht me 6 vjet e 8 muaj burgim.

48. Në analizë të vendimmarrjeve të gjykatave të faktit, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se fajësia e kërkuesve ishte provuar nga GJKKO-ja e Apelit në përputhje me parashikimet e nenit 152 të KP-së dhe përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Sipas saj, vendimi i GJKKO-së së Apelit, që kishte ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke deklaruar fajtorë kërkuesit për të gjitha akuzat, ishte i bazuar në ligj dhe në prova. Arsyetimi i asaj gjykate ishte i plotë dhe i detajuar, i mbështetur në analizën tërësore të përgjimeve telefonike, provave materiale, dokumenteve, vulave të falsifikuara, si dhe akteve të sekuestruara, nga të cilat rezultonte përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se Mimoza Ndoka kishte qenë anëtare aktive e grupit të strukturuar kriminal; kishte bashkëpunuar në mënyrë të qëllimshme dhe të vetëdijshme për përvetësimin e pasurive shtetërore nëpërmjet falsifikimit të dokumenteve dhe vulave; kishte përpiluar dokumente me përmbajtje të falsifikuara, të cilat kishin shërbyer për regjistrimin e titujve të pronësisë të falsifikuara në favor të grupit kriminal; kishte shpërdoruar tokenë përmes ndryshimit të paligjshëm të destinacionit të saj; kishte kryer veprime që përbënin pastrim të produkteve të veprës penale, sipas nenit 287, shkronja “a”, të KP-së. Ashtu siç GJKKO-ja e Apelit arsyetonte, kontributi i kësaj

kërkueseje nuk kishte qenë i thjeshtë, në kontekstin “familjar”, por i lidhur ngushtë me veprimtarinë kriminale të grupit. Po kështu, përfundimi i GJKKO-së së Apelit se përgjimet telefonike dhe dokumentet e sekuestruara provonin tej çdo dyshimi të arsyeshëm pjesëmarrjen e kërkuesit Bledi Ndokaj si anëtar aktiv në grupin e strukturuar kriminal, bashkëpunimin e qëllimshëm të tij në falsifikimin e dokumenteve dhe vulave për përvetësimin e pasurive shtetërore, si dhe përfshirjen në shpërdorimin e tokës, përmes ndryshimit të paligjshëm të destinacionit të saj, ishte gjithashtu i drejtë. Mes arsyetimit dhe dispozitivit të vendimit të asaj gjykate nuk kishte kontradikta dhe nuk evidentoheshin shkelje të natyrës ligjore.

49. Nga përmbajtja e vendimmarrjeve të gjykatave të zakonshme, Kolegji vëren se, në kundërshtim nga sa kërkuesit pretendojnë, përcaktimi i fajësisë së tyre është bërë bazuar në një analizë tërësore të provave të mbledhura gjatë hetimit, për rrjedhojë edhe prova të gjykimit të shkurtuar, dhe jo në një mjet të vetëm të kërkimit të provës, sikurse përgjimi, rezultatet e siguruara nëpërmjet të cilit, të zbardhura e transkriptuara në procesverbal, kanë sidoqoftë vlerën e provës së plotë të llojit “dokument” (fonografik) (*shih vendimin nr. 47, datë 20.04.2022 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*). Kjo analizë tërësore e provave i ka bindur gjykatat se fajësia e kërkuesve në kryerjen e veprave penale për të cilat ishin akuzuar provohej tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Për qëllime të përcaktimit të fajësisë së kërkuesve, GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë kanë analizuar faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë penale, si dhe përfshirjen e tyre, në bashkëpunim edhe me të pandehurin Gj.N. e të pandehur të tjerë, familjarë të tyre, në kryerjen e veprave penale në format e veçanta të organizatës kriminale e grupit të strukturuar kriminal, sipas përcaktimeve të nenit 28, pikat 1 e 4, të KP-së. Në përfundim, gjykatat kanë dhënë përgjigje të arsyetuara për qëndrimet e mbajtura në deklarimin e fajësisë së kërkuesve, duke shpjeguar lidhjen e provave me njëra-tjetrën, pa i dhënë ndonjëherë prej tyre vlerë të paracaktuar. Në kundërshtim nga sa kërkuesit pretendojnë, vendimmarrjet gjyqësore nuk rezultojnë me gabime të dukshme në drejtim të përcaktimit të fakteve në raport me veprat penale për të cilat ata janë dënuar dhe gjykatat nuk rezultojnë t’u kenë kaluar atyre barrën e provës. Gjatë procesit gjyqësor kërkuesit kanë pasur mundësi të paraqesin lirisht argumente dhe prova për kundërshtimin e pretendimeve të organit të akuzës e të parashtrojnë qëndrimet e tyre për provat e administruara në gjykim.

50. Kolegji vëren gjithashtu se, në kundërshtim nga sa kërkuesi Bledi Ndokaj pretendon, në analizë të vendimeve gjyqësore nuk rezulton që gjykatat ta kenë identifikuar ose referuar gabimisht atë. Përkundrazi, ato kanë përcaktuar qartë dhe pa ekuivoke komunikimet e veprimet e

tij nga ato të subjektit tjetër, me të cilin kërkuesi pretendon se është identifikuar gabim nga gjykatat, duke bërë dallimin përkatës midis tyre. Nga ana tjetër, arsyetimi i GJKKO-së së Apelit për deklaratimet vetakuzuese të këtij kërkuesi ka synuar nxjerrjen në pah të rezultateve të përfituara nga përgjimet telefonike lidhur me veprimet e tij. Kolegji vë në dukje se GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë i kanë dhënë përgjigje të arsyetuara edhe pretendimit të këtij kërkuesi se nuk ka mbajtur funksione shtetërore, duke shpjeguar se dënimi i tij për veprat penale të falsifikimit të dokumenteve, falsifikimit të vulave, stampave ose formularëve dhe shpërdorimit të tokës është bërë në kuadër të formës së bashkëpunimit të posaçëm me subjekte që kanë mbajtur funksione të tilla. Këto gjykata kanë arsyetuar për veprimet konkrete bashkëpunuese të kërkuesit në kryerjen e veprave në fjalë, të cilat kanë synuar përvetësimin në mënyrë të paligjshme të pasurive shtetërore nga grupi kriminal, duke ndikuar në ndërhyrjen në mënyrë të paligjshme në regjimin juridik të tokës përmes ndryshimit të destinacionit të saj. Ato kanë çmuar, në thelb, se pavarësisht mungesës së një funksioni shtetëror të kërkuesit, përfshirja e tij e vetëdijshme në veprimtarinë e paligjshme e bënte përgjegjës për veprat penale në fjalë.

51. Për sa më sipër, Kolegji çmon se konkluzionet e arritura nga gjykatat e zakonshme për përgjegjësinë penale të kërkuesve nuk rezultojnë në cenim të parimit të prezumimit të pafajësisë. Për rrjedhojë, pretendimet e kërkuesve për cenimin e këtij parimi janë haptazi të pabazuara.

52. Në kushtet kur, siç u vlerësua më lart, fajësia e kërkuesve për veprat penale të akuzuara është përcaktuar nga gjykatat përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, Kolegji vlerëson se nuk ka vend për pezullimin e ekzekutimit të vendimeve të kundërshtuara, ndaj ky kërkim i kërkuesve nuk mund të merret në shqyrtim.

53. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 e 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.